

Në përshëndetjen e tij, kryeministri Berisha u shpreh:

Përshëndetja e kryeministrit

"Pak çaste me parë rektori juaj më thotë se ne të arteve, fillimin e kemi të ndryshëm nga të tjerët. Ajo që me erdhi ndërmend ti them se juve të arteve, zoti, kur ndau gjuhët, ju dha gjuhën më të bukur të njeriut.

I nderuar zoti rektor, zoti, ministër, të dashur studentë dhe pedagogë të Akademisë së Arteve,

Është një kënaqësie e veçantë për mua tu përshëndes ju, shumë për zemërsisht, në ditën e parë të viti të ri akademik, të përshëndes gjithashtu të gjithë studentët dhe studentet e Shqipërisë, studentët e vitit të parë, trupën akademike të vendit, në këtë ditë të shënuar, për mbarë shoqërinë shqiptare.

Dita e fillimit të shkollës është gjithnjë një ditë e rëndësishme, e madhe, por dita e fillimit të këtij viti shkollor, për shqiptarët është më e madhja, sepse nisni vitin shkollor pas një vendimi historik të BE, për Shqipërinë dhe shqiptarët, për lëvizjen e lirë, pa viza në mbarë Evropën.

Në këtë akt madhor do të jeni ju student dhe studente, të rinjtë dhe të rejtat, të cilët keni fatin e madh ta nisni rininë tuaj studentore, jetën tuaj studentore, si qytetarë Evropianë, ta përfaqësoni vendin, kudo që jeni dhe kudo që ndodheni me dinjitetin që ju takon, ndaj dua tu uroj me këtë rast ju dhe të gjithë rininë shqiptare.

Por këtë vit ne nisim vitin e ri shkollor, me një arritje tjetër historike. Për herë të parë, në historinë e vendit tonë, këtë vit në shkollat e larta, në universitet e vendit, ulen 70 % e atyre që mbaruan maturën.

Kombi nuk mund të ketë alternative tjetër veçse të bazojë hapat e tij mbi dijen. Kjo është një arritje shumë e madhe. Në këtë arritje ne kemi realizuar një nga standardet më të larta të arsimit dhe jam bindur se krahas faktit se 91 % e tyre që mbaruan klasat e 9-ta, hynë sivjet në shkolla të mesme, me punën e madhe që do të bëjmë me cilësinë, ne do të shndërrojmë garën e dijes, në promotorin kryesor të zhvillimit të kombit dhe të vendit.

Të dashur studentë dhe studente, pedagogë dhe pedagoge,

Unë dua tu përgëzoj dhe tu përshëndes ju, për punën e shkëlqyer që bëni. Unë kam ndjekur me shumë interes, ecurinë, zhvillimet në akademinë tuaj. Unë gjej këtu një përpjekje serioze për të vendosur raportet më bashkëkohore, raporte të cilat, unë i ftoj edhe universitet e tjera ti marrin parasysh. Ju keni mbi 380 pedagogë për 950 studente. Ju keni 120 pedagogë efektivë. Këto janë raporte te domosdoshme. Ne si qeveri jeni të angazhuar të bëjmë çdo gjë, që studentët shqiptarë, kudo, në çdo degë të kenë pedagogët që ju nevojitem. Në një aspekt kemi të drejtë, universitetet i konsiderojmë shtretërit e mendimit intelektual të kombit, të tilla kane qene ato në të gjitha kohërat, ndaj nuk do të ngurojmë ti

mbështesim ato, me të gjithë mjetet financiare dhe të tjera, ndaj dua të theksoj se ne, në arsim jemi shumë ambicioz.

Unë në mënyrë të përsëritur dua ti kërkoj ministrit të arsimit të përdorim standardet e OECD. Këto janë standardet më të përparuara. Standardet më të përparuara të arsimit janë standardet e një grupi prej 30 vendesh më të zhvilluara të botës. Nuk mund të them se ne mund ti ndjekim ato standarde në teknologjinë e lartë apo në zbulimin shkencor, por ne duhet ti ndjekim ato standarde pavarësisht nga cmimi që ato kanë, ne duhet të përballemi me atë çmim, pasi ky është interesi më i mirë i vendit, interesi më i mirë i shoqërisë shqiptare.

Zoti Rektor, ju garantoj se qeveria ka një vëmendje të veçantë ndaj akademisë dhe artit në tërësi. Në këto 20 vite ne duhet të ndihemi krenarë në atë përfaqësim të shkëlqyer që kemi patur në skenat, galeritë e botës me nxënës të kësaj akademie apo talente të tjera shqiptare. Po të përlogarisim sa jemi si komb dhe sa kemi dhënë gjatë këtyre viteve e kemi shumë të mirë raportin. Artistë të mëdhenj shqiptarë, këngëtarë virtuozë kanë arritur suksese të jashtëzakonshme në operat më prestigjioze, si Inva Mula, Saimir Pirgu, apo në artet plastike, në artet pamore, në film, në të gjitha.

Është jashtëzakonisht e rëndësishme sepse ora jonë, jo që do jetë një orë globale dhe që është një orë globale, por do të jetë hiperglobale, sepse të vegjlit nuk mund të jenë ndryshe veçse hiperglobale në këtë univers. Në asgjë, më mirë se me ju, ne nuk mund të përfaqësohemi në Evropë dhe në botë dhe kjo kërkon natyrisht një mbështetje të fuqishme nga qeveria, për ju dhe të gjitha institucionet artistike.

Unë ju garantoj ju, rektorin, se për ministrinë e arsimit dhe qeverinë, mbështetja ndaj këtij institucioni për akademinë që ju doni ta ktheni në universitet dhe unë nuk kam asnjë kundërshtim, do të jetë e madhe. Kam shumë besim në pasionin, talentin, imagjinatën tuaj, se ju do të arrini me mbështetje, të shndërroheni në një nga qendrat më të fuqishme rajonale të artit.

Së fundi, kultura dhe identiteti janë sinonime të njëri-tjetrit. Ju operoni në fushën e parë të këtij kombi, por arti dhe kultura janë në fushën e parë të çdo kombi që është ajo e identitetit. Në këtë rast nuk është fjala këtu për një qëndrim nacionalist, e kundërta është fjala, për një shpalosje të madhe të vlerave të identitetit tonë kombëtar, vlera, të cilat, natyrshëm kanë evolucionin e tyre, nuk janë statike, janë dinamike, vlera që ushqehen, pasurohen, në mënyrë të vazhdueshme dhe ju jeni do të thosha kopshtarët e tyre, ju jeni artistët, shkrimtarët, poetët, jeni ata që i trajtoni ato.

Ndaj dhe në këtë kontekst ju garantoj se qëndrimi i qeverisë ndaj jush do të jetë një qëndrim tërësisht mbështetës. Kam përkrahur idenë e qytetit të arteve. Është absolutisht e domosdoshme që ju të keni ku të shprehni talentet tuaja, e domosdoshme që shoqëria të njihet me veprat tuaja krijuese, është e domosdoshme që ju të keni të gjitha hapësirat për të shpalosur talentin tuaj.

Së fundi, qeveria ka një fond, atë të ekselencës. Me këtë fond ne dërgojmë në universitetet më të mira të botës studentët, pedagogët, studentët për të përfunduar studimet, ndërsa pedagogët për doktoraturë, master jashtëuniversitar etj. Ju duhet në mënyrë imediate të përfshiheni në këtë fond dhe ju mund ta përdorini atë, si për të mbështetur talentet tuaja, në muzikë, në artet pamore, në artin skenik, po ashtu dhe për të sjellë këtu personalitet të shquara shqiptare të artit, muzikës, pikturës dhe pse jo dhe personalitete të tjera evropiane, botërore, për të gjallëruar sa më shumë jetën artistike, akademike të këtij institucioni.

Ndaj dhe unë do ta mbyll, duke ju uruar ju, fillimin e vitit të ri shkollor, duke ju garantuar ju, se qeveria do ju mbështesë në të gjitha projektet tuaja ambicioze.